



Nr. 22908 Prot.

Tiranë, më 14.12 2022

UDHËZIM

Nr 34 Datë 14.12 2022

“PËR

PROCEDURAT E MBYLLJES SË LLOGARIVE VJETORE TË BUXHETIT PËR VITIN 2022”

Në mbështetje të nenit 104, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 62 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pikës 272 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit nr. 24, datë 29.08.2019 “Për përdorimin e arkivës elektronike në procesin e ekzekutimit të buxhetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”:

UDHËZOJ:

I. PËRMBAJTJA DHE PUBLIKIMI I PASQYRËS FINANCIARE VJETORE TË KONSOLIDUAR TË SHPENZIMEVE DHE TË ARDHURAVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME:

1. Për llogari të Buxhetit të Shtetit të vitit 2022, në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme përfshihen:
 - a. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara, të regjistruara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022 (duke përfshirë datën 31.12.2022);
 - b. Të gjitha shpenzimet publike (përfshirë edhe shpenzimet nga kreditë e nënhuazuara të raportuara nga njësitë e zbatimit të projekteve të financimit të huaj, disbursimi i të cilave është konfirmuar nga struktura përgjegjëse për borxhin publik) të ndodhura (të dokumentuara) nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022 të njohura brenda kufirit të fondeve buxhetore disponibël dhe të regjistruara në SIFQ për

Ilogari të vitit 2022, pavarësisht nga data e kryerjes së pagesave.

- c. b/1 Në aneks të veçantë të raportohen të dhënat e detajuara sipas klasifikimit ekonomik (Ilogaritë ekonomike 600, 601, 602, etj.) të shpenzimeve kapitale me financim të huaj (Ilogaria ekonomike 230), të cilat raportohen në total kundrejt planit të buxhetit të treguesve fiskalë të konsoliduar, të regjistruar në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ).
 - d. b/2 Në aneks të veçantë të raportohen të dhënat e detajuara për shpenzimet dhe pagesat e detyrimeve të prapambetura sipas treguesve fiskalë të konsoliduar.
2. Për Ilogari të buxhetit të shtetit 2022, në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme, në seksionin e financimit të deficitit fiskal të përfshihen të gjitha transaksionet e regjistruara në SIFQ si më poshtë:
- a. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara nga shitja/privatizimi i aktiveve afatgjata publike gjatë vitit 2022;
 - b. Të gjitha arkëtimet e lidhura me huamarrjen e huaj deri në fund të datës 31.12.2022;
 - c. Të gjitha ri-pagesat e borxhit të jashtëm të kryera deri më datë 31.12.2022;
 - d. Të gjithë pagesat e principalit për efekt të garancive sovrane apo garancive të tjera të brendshme të ndodhura deri më datë 31.12.2022;
 - e. Ndryshimi i gjendjes së mjeteve monetare në Ilogaritë e çelura nga ministri përgjegjës për financat në Bankën e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë;
 - f. Gjendja e likuiditeteve në udhëtim që figurojnë si të tilla në fund të datës 31.12.2022.
 - g. Fitimi/humbja që rezulton nga transaksionet e këmbimit të mjeteve monetare ndërmjet nënlogarive në monedhat LEK, EURO, USD dhe SDR të Ilogarisë së unifikuar të Thesarit “Depozitë e qeverisë” (TSA) në Bankën e Shqipërisë si dhe ato të zhvlerësimit/rivlerësimit periodik të gjendjes vjetore të mbartur (balanca e Ilogarive të planit kontabël 657, 767, 766, etj.) të raportohen në nënzërin “Balanca nga kursi i këmbimit” të zërit “Të tjera” të burimeve të brendshme të financimit të deficitit.
3. Për efekt të paraqitjes në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme, fondet e planifikuara dhe të realizuara në kapitullin 08 për paga dhe sigurime, do të pasqyrohen në zërin “Shpenzime operative e mirëmbajtje”, sipas programeve dhe ministrive si më poshtë:
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë:
 - Programi 04130 “Mbështetje për zhvillim ekonomik”.
 - Ministria e Arsimit dhe Sportit :
 - Programi 09450 “Arsimi Universitar”;
 - Programi 09770 “Fonde për shkencën”.
 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:
 - Programi 07330 “Shërbimet e Kujdesit Dytësor”.
4. Për efekt të paraqitjes në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme, fondet e planifikuara dhe të realizuara për Rindërtimin për

qeverisjen qendrore dhe atë vendore, do të paraqiten në një zë të vetëm. (Fondi i Rindërtimit i ndarë për Grantet dhe për Shpenzimet e Rindërtimit).

5. Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër harton të dhënat faktike përfundimtare të pasqyrës vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme brenda datës 15.02.2023.
6. Pasqyra vjetore e konsoliduar e shpenzimeve dhe e të ardhurave të njërive të qeverisjes së përgjithshme publikohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në muajin shkurt 2023.
7. Pasqyra vjetore e konsoliduar e shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme e shoqëruar me raportimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2022, performancës makro-fiskale, situatës së menaxhimit të kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimit të brendshëm i paraqitet Këshillit të Ministrave brenda muajit Maj të vitit 2023.

II. MARRËDHËNIET E MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË ME BANKAT E NIVELIT TË DYTË

8. Në zbatim të marrëveshjes me ministrinë përgjegjëse për financat, bankat e nivelit të dytë kryejnë arkëtime të fondeve publike për llogari të vitit 2022 deri në fund të vitit 2022. Bankat e nivelit të dytë transferojnë në Bankën e Shqipërisë brenda orës 10:00 të datës së parë të punës në muajin Janar 2023, të gjitha mjetet monetare të arkëtuara për buxhetin e shtetit deri në fund të vitit 2022. Llogaritë e degëve të thesarit në bankat e nivelit të dytë do të fillojnë me gjendje zero në vitin 2023.
9. Degët e Thesarit përfundojnë rakordimin me bankat e nivelit të dytë dhe raportojnë elektronikisht në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër brenda datës 10.01.2023.
10. Sistemimet që nuk kanë ndikim në balancën e llogarisë unike të thesarit, do të kryhen në SIFQ nga vetë degët e thesarit dhe degët e bankave të nivelit të dytë, pa konfirmim nga struktura e thesarit në qendër.
11. Përmbledhëset për sistemimet, të cilat kanë ndikim në balancën e llogarisë unike të thesarit, krahas protokollit, do të paraqiten elektronikisht në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër deri më datën 18.01.2023 dhe do të kryhen nëpërmjet SIFQ me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Informacioni elektronik do të shoqërohet me akt-rakordimin e skanuar të mbajtur midis degës së thesarit dhe degës së bankës së nivelit të dytë.
12. Bankat e nivelit të dytë, para konfirmimit përfundimtar të rakordimit vjetor me strukturën përgjegjëse të Bankës së Shqipërisë dhe me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë, duhet të sqarojnë më parë mosrakordimet e mundshme me subjektet që operojnë dhe mënyrën e sistemimit të tyre.
13. Drejtoritë qendrore të bankave të nivelit të dytë rakordojnë me strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër, sipas formatit të dërguar nga kjo e fundit, brenda datës 19.01.2023.

III. MARRËDHËNIET E MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË ME BANKËN E SHQIPËRISË

14. Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të urdhërojë kryerjen e pagesave në Bankën e Shqipërisë deri në fund të sesionit të dytë të pagesave të datës 30.12.2022.
15. Llogaria “Depozitë e Qeverisë” dhe të gjitha llogaritë speciale të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në Bankën e Shqipërisë, në ditën e parë të punës të muajit Janar të vitit 2023, do të mbartin tepricën e mbylljes së këtyre llogarive në fund të vitit.
16. Procesi zyrtar i rakordimit me Bankën e Shqipërisë për arkëtimet dhe pagesat e qeverisjes së përgjithshme të kryera për vitin 2022 fillon në ditën e parë të punës të muajit Janar të vitit 2023. Më datën 25.01.2023 konfirmohet akt-rakordimi paraprak dhe më datën 08.02.2023 konfirmohet akt-rakordimi përfundimtar midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë.
17. Struktura përgjegjëse për borxhin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë përfundon regjistrimin në SIFQ të transaksioneve të borxhit të brendshëm dhe borxhit të jashtëm për vitin 2022, brenda datës 20.01.2023.
18. Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër harton brenda datës 08.02.2023 raportin përfundimtar të hyrjeve dhe daljeve të llogarisë bankare “Depozitë e Qeverisë”, për të cilën merr konfirmimin zyrtar nga Banka e Shqipërisë.

IV. MARRËDHËNIET E MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË ME NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

19. Bazuar në fondet buxhetore në dispozicion, nëpunësit autorizues të njërive të qeverisjes së përgjithshme do të urdhërojnë kryerjen e shpenzimeve deri më 29.12.2022, për të vijuar në muajin Janar të vitit 2023 në zbatim të nenit 52 “Kryerja e shpenzimeve” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përveç rasteve për të cilat është miratuar afat specifik nga ministri përgjegjës për financat. Struktura përgjegjëse për Thesarin në degë kryen kontrollin sipas legjislacionit në fuqi lidhur me vlefshmërinë e fondeve dhe ekzistencën e dokumentacionit që provon shpenzimin e ndodhur dhe të marrë në dorëzim brenda datës 29.12.2022, ora 13.00 (fatura e operatorit ekonomik duhet të jetë gjeneruar brenda vitit 2022). Dokumentacioni i paraqitur në Thesar pas datës 29.12.2022, ora 13.30 do të procesohet për pagesë në muajin janar të vitit 2023.
20. Për transfertat e fondeve buxhetore me formën e pagesës letër-kredi (LC) për kontrata të rëndësishme të veçantë (në zbatim të pikës 160 dhe 161 të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”), nga llogaria e unifikuar e thesarit “Depozitë e Qeverisë” në llogarinë bankare të veçantë të njësisë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme në një nga bankat e nivelit të dytë, në treguesit fiskalë të konsoliduar të qeverisjes së përgjithshme përfshihet gjendja bankare e fundit të vitit në zërin “Të tjera” të burimeve të financimit të brendshëm të deficitit.
21. Dega e thesarit Tiranë përfundon rakordimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe raporton në strukturën përgjegjëse të thesarit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë brenda datës 16.01.2023.
22. Njësitë e Projekteve me Financime të Huaja, ISSH dhe FSDKSH dorëzojnë raportin përfundimtar të të ardhurave e shpenzimeve në strukturën përgjegjëse për thesarin në

qendër brenda datës 16.01.2023.

23. Brenda datës 26.01.2023 përfundon paraqitja dhe regjistrimi në SIFQ i shpenzimeve të datuara në vitin 2022. Rakordimi përfundimtar për shpenzimet e kryera dhe të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2022 midis njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe degëve të thesarit kryhet në momentin që çdo njësi shpenzuese/arkëtuese përfundon regjistrimet në SIFQ, deri në fund të muajit janar 2023 për gjenerimin e të dhënave paraprake të treguesve fiskalë të konsoliduar 2022. Gjatë procesit, rakordohet edhe statusi i ekzekutimit të angazhimeve (kontratave) dhe kryhet mbartja e tyre në vitet në vijim, duke respektuar udhëzimin e operacioneve ditore në SIFQ brenda muajit shkurt 2023.
24. Në rastet e konstatimeve të gabimeve të regjistrimeve në sistem të shkresave të ndryshimit të planit vjetor të Buxhetit të Shtetit të vitit 2022, degët e thesarit i raportojnë si të tilla në strukturën përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër, të cilat bëjnë sistemimet përkatëse. Për çdo mospërputhje të këtyre planeve në nivel programi, projekti, kapitulli dhe llogarie ekonomike, do të bëhen sistemimet me strukturën përgjegjëse për buxhetin, e cila përgatit akt-rakordimin paraprak elektronik me njësitë e qeverisjes qendrore për planin përfundimtar të vitit 2022 deri në fund të muajit janar 2023.
25. Degët e thesarit për arkëtimet e vitit 2022, në favor të njësive të qeverisjes së përgjithshme (fonde të cilat në zbatim të legjislacionit përdoren nga njësia e qeverisjes së përgjithshme dhe trashëgohen në vitin 2023), mbartin tepricën e fondeve të papërdorura të të ardhurave të vitit 2022, në strukturat buxhetore përkatëse pas përfundimit të rakordimit vjetor, ndërsa mbartja pjesore e tepricës së fondeve disponibël mund të kryhet vetëm për pagesën e pagave (e shoqëruar me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe të tatimit mbi të ardhurat personale) si dhe transfertave me destinacion pagesën e pagave, ndihmave ekonomike, papunësisë dhe paaftësisë.
26. Mbartja e fondit të grantit të arsimit të lartë të papërdorur gjatë vitit 2022, do të bëhet sipas procedurës si më poshtë:
 - a. Të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë rakordojnë (duke mbajtur një akt-rakordim) me Degët e Thesarit lidhur me fondet e papërdorura gjatë vitit 2022 për grantin e arsimit të lartë përkatësisht në strukturat:
 - Grupi 11, Programi 09450, Kapitulli 08, Artikujt 600, 601, 602, 604, 605 dhe 606.
 - Grupi 11, Programi 09770, Kapitulli 08, Artikujt 600, 601, 602, 604, 605 dhe 606.
 - b. Kërkesa zyrtare për mbajtjen e fondeve të papërdorura së bashku me një kopje të këtij akt-rakordimi paraqitet pranë nëpunësit të parë autorizues për t'u mbartur si akordim plani në të njëjtën strukturë buxhetore në vitin pasardhës.
27. Fondet e akorduara për rindërtimin (korrente dhe kapitale), të cilat rezultojnë të pashpenzuara në fund të vitit buxhetor, dhe fondet të cilat janë të ngurtësuara në fund të vitit buxhetor, trashëgohen në vitin pasardhës dhe përdoren për të njëjtin qëllim. Mbartja e këtyre fondeve do të bëhet sipas procedurës si më poshtë:
 - Për njësitë e qeverisjes qendrore:
 - a. Njësitë e qeverisjes qendrore rakordojnë me Degët e Thesarit lidhur me fondet e rindërtimit të papërdorura (korrente dhe kapitale) gjatë vitit 2022 në strukturat buxhetore përkatëse (kodi i produktit të lidhet vetëm me fondin e rindërtimit), duke mbajtur një akt-rakordim.
 - b. Kërkesa zyrtare për mbajtjen e fondeve të papërdorura të rindërtimit së bashku me një kopje të akt-rakordimit, paraqitet pranë nëpunësit të parë autorizues për t'u mbartur si

akordim plani në të njëjtën strukturë buxhetore në vitin pasardhës.

- Për njësitë e vetëqeverisjes vendore:
 - a. Fondet e akorduara për rindërtimin për njësitë e vetëqeverisjes vendore (korrente dhe kapitale), si dhe fondet e ngurtësuar, të cilat rezultojnë të pashpënuara në fund të vitit buxhetor, trashëgohen në vitin pasardhës dhe përdoren për të njëjtin qëllim.
 - b. Njësitë e vetëqeverisjes vendore rakordojnë me Degët e Thesarit lidhur me fondet e rindërtimit të papërdorura (korrente dhe kapitale) dhe ato të ngurtësuar, gjatë vitit 2022 në strukturat buxhetore përkatëse (kodi i produktit të lidhet vetëm me fondin e rindërtimit), duke mbajtur një akt-rakordim.
 - c. Një kopje të akt-rakordimit të mbajtur me thesarin për fondet e papërdorura të rindërtimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore e dërgojnë në strukturën përgjegjëse për Buxhetin, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, brenda muajit janar të vitit 2023.
- 28. Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër publikon të dhënat faktike të detajuara në nivel njësie shpenzuese sipas strukturës buxhetore në faqen elektronike zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, brenda muajit Janar të vitit 2023.
- 29. Struktura përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë rakordon me njësitë e qeverisjes qendrore, planin e buxhetit të shtetit të vitit 2022 në nivel grupi, programi, produkti, kapitulli dhe artikulli, përfshi edhe limitin e përdorimit të të ardhurave të institucioneve buxhetore. Gjithashtu, njësitë e qeverisjes qendrore, duhet të raportojnë shumën e shpenzimeve të realizuara nga të ardhurat jashtë limitit.
- 30. Në zbatim të Udhëzimit nr. 35, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, të dhënat e detyrimeve të prapambetura (vlera e stokut, e paguar dhe krijuar rishtazi), duhet të rakordohen brenda datës 27.01.2023 midis njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme dhe degëve të Thesarit, të cilat menjëherë raportojnë përkatësisht në strukturën përgjegjëse për Thesarin pranë ministrisë përgjegjëse për financat sipas formatit të raportit të gjeneruar nga SIFQ për publikim më 01.02.2023.
- 31. Procesi i regjistrimit në SIFQ dhe rakordimit me kreditorët për financimet e huaja midis strukturave përgjegjëse të thesarit, borxhit dhe njësive të qeverisjes së përgjithshme duhet të përfundojë brenda datës 10.02.2023.
- 32. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojnë në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë dhe në bazë të akt-rakordimit të mbajtur me strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë në strukturën përgjegjëse për financat vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë sa më parë të jetë e mundur brenda datës 21.01.2023 për fondet e papërdorura në vitin 2022, të detajuara sipas burimeve të financimit si më poshtë:
 - a. Nga granti i qeverisjes qendrore, në Kapitullin 1 “Çelje nga buxheti”;
 - b. Nga projektet me financim të huaj, në Kapitullin 2 “Financimi i Huaj”;
 - c. Nga të ardhurat e krijuara nga kryerja e veprimtarisë së tyre, në Kapitullin 5 “Të ardhurat e veta”;
 - d. Nga të ardhurat e krijuara në zbatim të legjislacionit specifik, në Kapitullin 6 “Të ardhurat jashtë limitit”.

V. RAKORDIMI DHE MBYLLJA E LLOGARIVE TË TJERA VJETORE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

33. Rakordimi, mbyllja e llogarive të tjera vjetore të njësisve të qeverisjes së përgjithshme dhe hartimi i pasqyrave financiare vjetore do të kryhet në bazë të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””.
34. Degët e thesarit gjenerojnë nga sistemi i SIFQ brenda muajit Janar të vitit 2023 (në varësi të afatit të përfundimit të rakordimit vjetor) informacionin financiar disponibël/pasqyra financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ky informacion shërben si referencë për nëpunësit zbatues gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë. Të dhënat përfundimtare kontabël pasqyrohen në SIFQ (në periudhën e 13-të) nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në degë, në zbatim të manualeve përkatëse.
35. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme me vetëfinancim hartojnë pasqyrat financiare vjetore sipas formatit të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë (pika 33 e këtij udhëzimi) në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë (e cila vë në dispozicion të dhënat elektronike ekzistuese në SIFQ deri në fund të muajit Janar të vitit 2023). Të dhënat përfundimtare të pasqyrave financiare vjetore 2022 paraqiten brenda muajit Mars të vitit 2023, në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë dhe në strukturën përgjegjëse për statistikën pranë INSTAT-it.
36. Njësitë e projekteve me financim të huaj raportojnë në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë të dhënat e munguara të pasqyrave financiare për periudhën e mëparshme deri në 31.01.2023.
37. Në zbatim të pikave IV-a.9 dhe V-6 të Udhëzimit nr. 24, datë 29.08.2019 “Për përdorimin e arkivës elektronike në procesin e ekzekutimit të buxhetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të dhënat vjetore kontabël për të cilat ekziston mundësia e ngarkimit në Web Portal do të ruhen në arkivën elektronike, ndërsa të dhënat për të cilat nuk ekziston mundësia e arkivimit elektronik do të paraqiten fizikisht me protokoll në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë, e cila i rakordon me të dhënat përfundimtare të regjistruara në SIFQ.
38. Struktura përgjegjëse për borxhin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të raportojë në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër të dhënat e pasqyrave financiare të vitit 2022 për borxhin e Qeverisë Qendrore brenda muajit Mars të vitit 2023. Gjithashtu, struktura përgjegjëse për borxhin, brenda datës 31.03.2023 duhet të raportojë në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër të dhënat e vitit 2022 për nënhuatë.
39. Strukturat përgjegjëse për kontabilitetin në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “online” me SIFQ të saktësojnë të dhënat e inventarëve të aseteve jofinanciare dhe të raportojnë të dhënat e munguara të migrimit në strukturën përgjegjëse për Thesarin në qendër për t’i ngarkuar në SIFQ, duke mundësuar gjenerimin e të dhënave të konsoliduara të pasqyrave financiare të përputhura me të dhënat e paraqitura fizikisht (“hard copy”) në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë.
40. Pas përfundimit të gjenerimit të të dhënave të konsoliduara të pasqyrave financiare vjetore 2022, struktura përgjegjëse e Thesarit në qendër, në bashkëpunim me INSTAT dhe Bankën

e Shqipërisë (në zbatim të memorandumit të përbashkët të mirëkuptimit), harton të dhënat e tabelave të statistikave financiare të qeverisë (GFS-Government Finance Statistics) sipas metodologjisë së Fondit Monetar Ndërkombëtar - GFSM2014, të cilat përshtaten nga INSTAT me metodologjinë e Bashkimit Europian - ESA10 për të mundësuar raportimin në EUROSTAT dhe në FMN deri në fund të muajit Shtator të vitit 2023.

VI. MASA ADMINISTRATIVE

41. Procesi i rakordimit përfundimtar të të ardhurave dhe shpenzimeve të qeverisjes së përgjithshme, si dhe mbyllja e llogarive vjetore të buxhetit të shtetit, monitorohet nga Nëpunësi i Parë Autorizues nëpërmjet strukturës përgjegjëse për thesarin.
42. Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga ana e punonjësve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të përfshirë në proces, do të aplikohen masa administrative sipas shkallës së shkeljes së provuar.
43. Do të aplikohen gjoba nga 1-3 paga mujore deri në largim nga puna mbi të gjithë specialistët e degëve të thesarit që regjistrojnë fatura me datë përpara datës së paraqitjes së tyre në Thesar, apo pa respektuar radhën kronologjike të paraqitjes së faturave nga institucionet në Thesar, pasi shkaktojnë artificialisht krijimin e detyrimeve të prapambetura në sistem.
44. Procedura e ndjekur dhe shpenzimet e regjistruara në SIFQ nga punonjësi i degës së thesarit sipas pikës 19 të këtij udhëzimi do të jetë objekt monitorimi nga Nëpunësi i Parë Autorizues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Për shkeljet e konstatuara merret masë administrative deri në largim nga puna të punonjësit të thesarit.
45. Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga ana e nëpunësve autorizues dhe zbatues të njësive të qeverisjes së përgjithshme, Nëpunësi i Parë Autorizues zbaton penalitetet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
46. Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga bankat e nivelit të dytë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë aplikon penalitetet e parashikuara në marrëveshjet me bankat.
47. Për të gjitha kthimet e pagesave elektronike që janë për shkak të:
 - a. Udhëzimeve të gabuara për plotësimin e dokumentacionit të paraqitur në thesar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pagesa e komisionit bankar do të bëhet nga fondet operative të këtyre të fundit, me iniciativë të strukturës përgjegjëse për thesarin, në bazë të procesverbalit të mbajtur midis njësisë shpenzuese dhe degës së thesarit;
 - b. Regjistrimit të gabuar nga specialisti i degës së thesarit, atëherë pagesa e komisionit do të mbahet nga paga e specialistit;
 - c. Gabimeve nga banka e nivelit të dytë, atëherë nuk do të paguhet komision, por me bankën përkatëse do të mbahet procesverbal për mosrespektimin e kushteve të marrëveshjes.

Për të gjitha rastet e udhëzimeve të gabuara, banka e nivelit të dytë bën kthimin menjëherë të pagesës së gabuar në Llogarinë Unike të Thesarit, për t’u proceduar me korrigjimin nga degët e thesarit në bashkëpunim me njësinë shpenzuese.

48. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për përpilimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e të dhënave

periodike të treguesve fiskalë të konsoliduar të buxhetit sipas rregullore së brendshme, të cilat do të përpilojnë raportimin periodik dhe vjetor të ndryshuar.

49. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Delina Harahimaj

